



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Nr. Prot. 4258/

Tiranë, më 5.12.2022

REZULTATI I SHORTIT TË HEDHUR
PËR ZGJEDHJEN

E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI, PËR VITIN 2023

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z Bajram Begaj, në zbatim të plotë të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, zhvilloi sot, më datë 5 dhjetor 2022, ora 10:00, shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të cilët e ushtrojnë detyrën me një mandat një vjeçar. Mandati i anëtarëve të këtij Këshilli, ushtrohet prej datës **1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023**.

Shorti u hodh në prani të Avokatit të Popullit, zonjës Erinda Ballanca, e cila vëzhgoi procesin, si dhe të përfaqësuesve nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, z. Alfred Balla dhe znj. Xhensjana Vathi, nga Gjykata Kushtetuese, z. Aleksandër Toma, Kuvendi i Shqipërisë me përfaqësues znj. Dhurata Tuli dhe znj. Mimoza Arbi, përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, z. Aleksandar Romanovic dhe znj. Fanny Svensen, si edhe përfaqësues nga Ambasada Amerikane, znj. Klodiana Vogli.

Në përfundim të hedhjes së shortit, rezultoi se anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2023, janë:

Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë përgjatë vitit 2023:

1. Z. Altin Binaj nga Gjykata Kushtetuese
2. Znj. Fjona Papajorgji nga Gjykata Kushtetuese
3. Z. Sandër Simoni nga Gjykata e Lartë
4. Z. Arqileta Koça nga Prokuroria e Përgjithshme
5. Z. Fuat Vjerdha nga Gjykatat e Apelit
6. Z. Engert Pëllumbi nga Gjykatat e Apelit
7. Znj. Arta Marku nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
8. Z. Gjon Fusha nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
9. Znj. Enerjeta Shehaj (Denaj) nga Gjykatat Administrative

Anëtarët zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të zgjedhur me short, sipas të njëjtës procedurë, janë si më poshtë:

1. Znj. Vitore Tusha nga Gjykata Kushtetuese
2. Znj. Albana Boksi nga Gjykata e Lartë
3. Znj. Alma Muça nga Prokuroria e Përgjithshme
4. Z. Genti Shala nga Gjykata e Apelit
5. Z. Moisi Duda nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
6. Znj. Elda Vrioni nga Gjykatat Administrative

Procedura e hedhjes së shortit filloi në orën 10:00 dhe përfundoi në orën 10:50

Tiranë, më 5 dhjetor 2022, ora 10:00



Sekretariati Teknik:

1. Znj. Mirela Dinaj, Specialiste për Burimet Njerëzore
2. Znj. Loreta Bejleri, Specialiste për Protokollin
3. Znj. Bianka Hada, Specialiste për Sistemet e Informacionit
4. Znj. Dile Zhuri, Specialiste për Sistemet e Informacionit
5. Znj. Esmeralda Velaj, Specialiste për Vlerësimin e Akteve